

## URATAT E RUSHAJEVE

*Pas Meshes nis menjehere Mbremesorja:*

DHJAKU: Bekó, o Atc.

PRIFTI: I bekuar është Perendia ync, gjithënjë taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

KENDONJESI: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

Triní e tereshenjte, meshirona; o Zot, hiresoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona; o i Shenjte, veshtroji, dhe sheroji semundjet tona per emrin tent. Meshiró, o Zot (3 here).

Ati ync, qe je ne qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbreteria jote; u-befte deshira jote si ne qell edhe mi dhé; buken tone te perdicime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtóreve tanc; edhe mos na shtjer ne ngasje, po shpetona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja është Mbreteria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pas Psalmit Nistór, Dhjaku thote Litanine e Madhe:*

DHJAKU: Me paqe le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per paqen qe lártazi dhe per shpëtimin e shpírteve tona, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per paqen e tere botes, per mirevajtjen e Kísheve te shenjta te Perendise dhe per bashkimin e te gjithave, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per Kryepeshkopin tone (aksh), per prifterine dhe dhjakerín' e nderuar me Krish-tin, per tere klerin dhe pópullin, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per pópullin që rri rotull, edhe për hirin e Shpirtit Shenjt, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Për atá, që i unjin përpara Perendisë gjunjët edhe zemrat e tyre, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Që të pritet lutja jonë e përgjnjur përpara Perëndisë si temjân, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Që të shpëtojme prej çdo hidherimi, merie, reziku dhe nevoje, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Përkrahna, shpëtona, meshirona dhe rúajna, o Perëndí, me hirin tënt.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, të pacinúaren, të permibekúaren, të lavderúaren, Kryezonjen tonë, Hyjlíndësen dhe gjithënjé Virgjreshen Marí dyke kujtuar me gjithë Shenjtoret, veten tonë dhe njerjatrín dhe tërc jeten tonë Krishtit Perëndí le tja pranojme .

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Se ty të ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj thuhën Thirrtoret me gjashtë Vargëzime të Vëtezshme të Lavderímeve me T. IV:*

Ty o Zot, të thirra në mëngjës; degjoma lutjen, degjoma lutjen, shpejt o Zot. Ty o Zot, të thirra në mëngjës; degjoma lutjen, ver-i veshin zërit të lutjes sime. Ja ku të therrës që në mëngjës; degjoma lutjen, shpejt o Zot.

Le të drejtohet posi temjani, lutja ime sot, përpara teje; dúart' i ngre përpyetë, për mbreme si për kurbán; degjoma lutjen, shpejt o Zot.

Po ti vesh re paudhësitë, kush munt të qëndronjë përpara teje? Po pranë teje është ndjesa.

Gjera të çudíçime, pañë gjithë kombet në qytetin e Davidit, kur zbriti Shpirti Shenjt në formë gjuhësh prej zjarri, sikunder thotë Shen Lukáj Ungjillori: Atjë ku ishin mbledhur Dishépujt' e Krishtit, ardhí një oshetím si prej ere të reptë, dhe e mbushi shtëpinë ku rrinin; dhe nisnë të flasin fjale të húaja, doktrina të húaja, mesime të húaja të Trinisë së Shenjtë.

Jam dyke pritur Zotin, edhe shpirti im ka shpërsë në fjalën e tij.

Gjera të çudíçime, pañë gjithë kombet në qytetin e Davidit, kur zbriti Shpirti Shenjt në formë gjuhësh prej zjarri, sikunder thotë Shen Lukáj Ungjillori: Atjë ku ishin mbledhur Dishépujt' e Krishtit, ardhí një oshetím si prej ere të reptë, dhe e mbushi shtëpinë ku rrinin; dhe nisnë të flasin fjale të húaja, doktrina të húaja, mesime të húaja të Trinisë së Shenjtë.

Që në mëngjës gjer mbrémame le të shpërenjë Israeli me Zotin.

Shpirti Shenjt ishte gjithenjë, eshte dhe do te jete, as nisi as pushón, po esht i bashkuar me Atin e me Birin; i mire dhe burím i miresise, me anen e te cilit njihet Ati, dhe lavderohet Biri, dhe leçitet prej te gjithëve, si nje fuqí dhe nje bashkím, dhe nje adhurím i Trinise se Shenjte.

Se Zoti ka meshire, dhe aý do ta çperblenje Israelin nga te gjitha paudhesite.

Shpirti Shenjt ishte gjithenjë, eshte dhe do te jete, as nisi as pushón, po esht i bashkuar me Atin e me Birin; i mire dhe burím i miresise, me anen e te cilit njihet Ati, dhe lavderohet Biri, dhe leçitet prej te gjithëve, si nje fuqí dhe nje bashkím, dhe nje adhurím i Trinise se Shenjte.

Lavderójeni Zotin, gjithe kombet; lavderójeni, gjithe pópujte.

Shpirti Shenjt eshte drite dhe jete, dhe burím i gjalle shpirterór; Shpirt i urtesise, i miresise dhe i drejtesise; Shpirt mendór dhe zoterór, qe i paqesón mekatat; Perendí dhe perendimtár; zjarr prej zjarri qe flet, qe veperón edhe qe perndán dhurata; me anen e te cilit u-kurorezuan Profetet, Apostujte dhe Deshmoret. Lajme e çudíçime, pamje e çudíçime, zjarr qe perndahet ne pjesa dhuratash.

Se ka patur meshire te madhe per né, dhe e verteta e Zotit mbreterón per jete.

Shpirti Shenjt eshte drite dhe jete, dhe burím i gjalle shpirterór; Shpirt i urtesise, i miresise dhe

i drejtesise; Shpirt mendór dhe zoterór, qe i paqesón mekatat; Perendí dhe perendimtár; zjarr prej zjarri qe flet, qe veperón edhe qe perndán dhurata; me anen e te cilit u-kurorezuan Profetet, Apostujte dhe Deshmoret. Lajme e çudíçime, pamje e çudíçime, zjarr qe perndahet ne pjesa dhuratash.

LAVDI E TANI, T. T. II: O Mbret qellór, o ngushellimtár, o shpirti i se vertetes, qe ndodhesh kudó dhe i mbush te gjitha, thesár i te mírave dhe fales i jetes, eja dhe tendesó ner né, dhe spastro na prej çdo njolle, dhe shpctoji shpirtet tona, o i mire.

*Pastáj behet Hyrja me Temjanicen:*

KORI: Drite gazmore e lavdise qellore, Jesú Krisht, si arrime perendimin e díellit, edhe pame driten e mbremes, hymnojme Atin e Birin edhe Shpirtin Shenjt, se te ka hie kenga kurdohere, o i Bir i Perendise, qe fal jeten, perandáj te lavderón e tere bota.

DHJAKU: Parevargu i Mbremes.

KORI: Cili Perendí esht aq' i math sa Perendia yne. Ti je i vétemi Perendí, qe ben çudira (3 here).

*Pastáj Dhjaku thote:*

DHJAKU: Perserí dhe perserí, dyke rene me gjunje, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

*Passi bien te gjithe me gjunje, Pifti i pergjunjur kendón me ze te larte keté Urate nga Dera e Bukur:*

PRIFTI: O Zot meshireplót e njeridashes, degjoji lutjet tona ditën e Rushájeve, në të cilën Shpirti Shenjt i ndriçoj Apostujtë me gjúhera prej zjarri; pritna né, që të biem nër kembë dhe të lypim meshirë për mekátat tona; mbuloji paudhësítë tona me dhëmpsherít' e tua; veshtróje pópullin, që rri rotull, edhe pret meshirën e pasur prej teje; shpetona nga tiraní' e Djallit; falna ndjësën e mekátave të dáshura dhe të padáshura; paqësóna me veprimin e Shpirtit Shenjt; armatisna me armët e drejtësísë; mblihná të gjithë në Mbretërinë qëllorë; me nërmjetimet e Shen Marisë dhe të gjithë Shenjtórvë, që të kanë gëzuar prej jete.

KORI: Amín.

DHJAKU: Perkrahná, shpetona, meshiróna, ngrërna dhe rúajna, o Perendí, me hirin tënt.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, të pacinúaren, të permibekúaren, të lavderúaren, Kryezonjen tonë, Hyjlíndesën dhe gjithënjé Virgjërshën Marí dykë kujtuar me gjithë Shenjtoret, veten tonë dhe njerjatrín dhe tërë jetën tonë Krishtit Perendí le tja pranojmë .

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Se ti na meshirón, e na shpetón, dhe ty të dergojmë lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetët e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj Dhjaku thote Litaninë e Gjere:*

DHJAKU: Le të thomi të gjithë me tërë shpirtin dhe me tërë mendjen tonë, le të thomi.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: O Zot i tërëfuqishim, Perendí i Aterve tanë, të lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Meshiróna, o Perendí, pas meshirës sate së madhe, të lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe për Kryepeshkopin tonë (aksh) dhe për tërë Vëllazërinë tonë me Krishtin.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe për Presidentin e Shtëtëve të Bashkúara të Amerikës edhe për ushtërinë dhe aniesinë amerikane.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe për themeltarët e lumit të kesáj Kishe së shenjte, për vëllëzerit edhe áterit tanë dhe për gjithë të Krishtëret besëmirë, që prehen ketú dhe kudó.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe për meshirën, jetën, paqën, shëndetin, shpetimin, veshtrimin, edhe ndjësën e mekátave të shërbëtoreve të Perëndisë (aksh).

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Lútemi edhe për themeltarët, kujdestarët, famulltarët, përkráhesit, mirebéresit, puntoret edhe këndónjesit e kesáj Kishe së

shenjtc dhe per pópullin, qe rri rotull, edhe pret meshiren e pasur dhe te madhe prej teje.

KORI: Meshiró, o Zot (3 *here*).

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót e njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

DHJAKU: Perserí dhe perserí, dyke rrene me gjunje, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Zot meshireplót e njeridashes, degjoji lutjet tona, dhe prehi áterit e nenat, vellézërit e motrat, femijet e njekómbasit, edhe gjithë shpirtet e te Krishtëreve besemire, qe ndehen ketú e kudó; shkrúaj emrat e tyre ne libren e jetes; vendos-i shpirtet e tyre ne gjirin e Abrahamit, Isakut e Jakobit, ne Parajsen e te gjálleve, ne Mbretërin' e qejve; me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve, qe te kane gezuar prej jete.

KORI: Amín.

DHJAKU: Perkraha, shpetona, meshirona, ngrerna dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Terreshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithënjé Virgjereshen Marí dyke kujtuar me gjithë Shenjtoret, veten tone dhe

njerjatrín dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le tja pranojme .

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Me hirin e Birit te vetem, me te cilin je i bekuar, bashke me Shpirtin e terreshenjtc dhe te mire dhe jeteberes, taní e perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

KENDONJESI: Vleresona, o Zot, keté dite te rúhemi pa nonjë mekát. I bekuar je, o Zot, Perendí i Aterve tane, dhe emri yt esht i kenduar dhe i lavderuar per jete. Amín. Le te jete, o Zot, perdelimi yt mi né, sikunder kemi shpresuar mi ty. I bekuar je, o Zot, mesome te drejtat e tua (3 *here*). Ty te ka hie levdata, ty te ka hie kenga, ty te ka hie lavdia, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jeteve. Amín.

DHJAKU: Perserí dhe perserí, dyke rrene me gjunje, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Zot meshireplót e njeridashes, kij meshire per né, sherbetoret e tu mekatore dhe te pavyer; ndjena dhe falna paudhesite, te dáshura dhe te padáshura, te dítura dhe te padítura, te çfáqura dhe te fshéhura, te veperúara, te mejtúara, dhe te fólura; dhurona lirine dhe prehjen e shpírteve dhe te trúpeve; bekoje tere pópullin, qe rri rotull; forcona per te mbaruar porrosít' e tua; falna mbarím te mire dhe paqesór; pritna me dhempsherí, kur te kthehesh prape me lavdí qe ti

gjdkósh te gjallet e te vdékurit; edhe vleresona per Mbretërinë qellore; me nermjetimet e Shen Marisë dhe te gjithë Shenjtórove, qe te kanë gëzuar prej jete.

KORI: Amín.

DHJAKU: Perkraha, shpetona, meshirona, ngrerna dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithënjé Virgjreshen Marí dyke kujtuar me gjithë Shenjtoret, veten tone dhe njerjatrín dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le tja pranojme .

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Se ti je prchja e shpírteve dhe e trúpeve tona, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj Dhjaku thote Litanine e Gjate:*

DHJAKU: Le tja mbarojme lutjen tone mbremesore Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Mbremen e tere, te mbare, te shenjte, te paqme dhe te pamekatme, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Gngjell páqeje, udheheqes besnik,

rúajtes te shpírteve dhe te trúpeve tona, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Ndjesë dhe falje te fájeve dhe te mekátave tona, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Te mirat e te dobishmet per shpirtet tona dhe paqe per boten, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Qe ta shkojme kohen e mbetur te jetes sonë me paqe dhe me pendím, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Mbarím te krishtere, paqesór dhe faqebardhe te jetes sonë, dhe mprojtje te mire perpara Gjykatores se trémpshime te Krishtit, le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithënjé Virgjreshen Marí dyke kujtuar me gjithë Shenjtoret, veten tone dhe njerjatrín dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le tja pranojme.

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót e njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Paqe te gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tende.

DHJAKU: Kreret tona Zotit le tja unjim.

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Qoftë e bekuar dhe e lavderuar Mbretëria jote, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj kendohen Pasvargjet me T. III:*

Taní arthnë gjuhët e zjarrit, si një shenje për të gjithë; se Judenjtë, nga të cilët lindi trupërisht Jesúj, u-semurnë nga pabesia, dhe ranë prej hirit perendór, po paganët u-vlescruan për driten e Ungjillit me leçitjen e Apostujve, me të cilët adhurojmë Shpëtimtarin e shpërtheve tona.

Khjelloma zemrën, o Perendí, dhe perscritma frymen e drejtë.

Taní Shpirti ngushëllimtar u-derth mi gjithë njërezit, në formë gjuhësh prej zjarri, dyke nisur nga Apostujtë, për lavdín' e Perendisë; perandáj le të lútemi që të shpëtonjë shpirtet tona.

Mos me hith tej prej faqes sate, dhe mos ma merr frymen tënde të shenjtë.

Taní vishen me fuqinë qellore Apostújt' e Krishtit; se i perscriti Ngushëllimtari, me diturín' e re mistike, dhe leçitnë me gjuhë të húaaja adhurimin e Trinisë, për shpëtimin e shpërtheve tona.

LAVDI E TANI, T. T. IV: Ejani o popuj, të adhurojmë Trininë, Atin e Birin edhe Shpirtin

Shenjt edhe të thomi: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur meshirona. Triní e shenjtë lavdí me ty.

*Pastáj thuhet Tropari i Simeonit:*

Taní perleshojë shërbëtorin tënt, o Zot, me paqe pas fjales sate, se syt' e mi janë shpëtimin tënt, që përgatite përpara faqes së gjithë pópujve, dritë për të ndriçuar paganët, edhe lavdí për pópullin tënt Israél.

KENDONJESI: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perherë dhe në jetet e jéteve. Amín.

Triní e tërëshenjtë, meshirona; o Zot, hiresoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhësitë tona; o i Shenjtë, veshtroji, dhe sheroji sëmundjet tona për emrin tënt. Meshiró, o Zot (3 here).

Ati ynë, që je në qell, u-shenjtëroftë emri yt; arthtë Mbretëria jote; u-bëftë dëshira jote si në qell edhe mi dhé; bukën tonë të përdíçime épnaje nëve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtórëve tanë; edhe mos na shtjer në ngasjë, po shpëtona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja është Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj thuhet Perleshorja e Rushájeve:*

T. T. IV: Je i bekuar o Krisht Perendí dhe Zot,

qe i çfaqe, Shen Apostujte peshkatare, mé te urtet e tere botës me Shpirtin Shenjt, dhe me atá rjetove dhenc anembanc, njeridashes lavdí me ty (3 here).

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia ync, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtiti Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (3 here). Bekó, o Atc.

*Pastáj Prifti ben keté Perlshím:*

PRIFTI: Krishti, Perendia ync i vertete, qe zbriti prej qellit edhe u-be njerí, pastáj u-ngjit ne qellin perscri, dhe ndenji me te djathten e Atit, edhe u dergój Apostujve Shpirtin Shenjt ne forme gjuhesh prej zjarri, dhe i ndricój atá, dhe me anen e tyre dhen' e tere; me nermjetimet e Shen Marise; te Shen Apostujve te lavderuar dhe emershkelqyer; dhe te gjithc Shenjtóreve; na meshirofte, dhe na shpetofte si i mire dhe njeridashes.

KORI: Amín.